

S T A T U T
I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

“KK TERMOIDRAULIKA” SHPK

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- “Statuti” është Statuti i Shoqërisë;
- “Ditë të Plota” në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.
- Shumicë e thjeshtë janë ortakët që zoterojnë më shumë se 30% të kapitalit të Shoqërisë.
- Shumicë absolute janë ortakët që zoterojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë.
- Shumicë e cilësuar janë ortakët që zoterojnë jo më pak se 75% të kapitalit të Shoqërisë

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe Adresa e Faqes së Internetit (nëse ka)

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më 13.09.2021 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin e subjektit “KK TERMOIDRAULIKA” sh.p.k dhe emrin tregtar KK TERMOIDRAULIKA.
2. Themeluesit i shoqërisë jane :
 - **Z. Kleviš Kapllaj**, i datëlindjes 30/04/1988, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhë dhe banues ne Lezhë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr 032360980 dhe Nr. Personal I80430053H

Neni 2
Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

- Aktivitet ne fushen e ndertimit dhe rikonstruksionit te ndertimeve civile, objekte te sherbimit dhe banimit, punime hidraulike.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e papercaktuar.

Neni 4
Selia, Adresa e Faqes së Internetit (nëse ka) dhe Adresa Elektronike (nëse ka)

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në Lezhë, në adresën: **Lezhë, Shëngjin, Ishull Lezhë, Banesë private me Nr. Pas. 53/604, ZK Nr. 1986.**

Kreu II
Kapitali i Regjistruar

Neni 5
Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është Lekë 100.000 (njeqind mijë leke). Duke qene se kjo shume do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas regjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare. Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikaur ne kete Statut.
2. Pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:
 - Klevis Kapllaj, i cili zoteron 1 kuote me vlore nominale prej 100,000 leke dhe pjesëmarrje ne kapital prej 100,00%.

Lloji i kontributit: ne para

3. Kontributet në para jane paguar plotesisht dhe menjëherë.

Neni 6
Kërkesa për të paguar kuotat dhe térheqja e kuotave të papaguara

1. Administratori/ët me të drejta të plota mund t'u kërkojë/në ortakëve egzistues ose të rinj të Shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.
2. Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

3. Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratori/ët mund të njoftojnë paraprakisht të paktën katërmëdhjetë Ditetë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumat e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarimin se në rast mosbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.
4. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përparrë se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorit/ëve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluara dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.
5. Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpérndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratorët konsiderojnë të përshtatshme.
6. Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë por do të jetë personalisht përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përparrë anulimit të kuotës.

Neni 7 **Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë te cilësuar.

Neni 8 **Certifikatat e kuotave**

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave.

Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gjëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 9 **Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

1. Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- shitblerjes;

- dhurimit;
 - trashëgimisë;
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
3. Në cdo rast, për shitjen e çdo kuote është e detyrueshme miratimi i shoqërisë me vendim të shumicës së cilësuar. Nga ky rregull nuk bëjnë përjashtim personat me lidhje familjare dhe çdo tjetër.
- Në rastet kur një ortak kërkon që t'i shesë kuotat e tij tek një tjetër duhet në çdo rast miratimi i me shkrim i ortakëve të tjerë. Ortakët egzistues kanë të drejtën e parablerjes së kuotave të ortakut që largohet duke u bazuar në çmimin e kuotës sipas kapitalit themeltar të deklaruar prej shoqërisë dhe/ose bazuar në një vlerësim të marrë nga një ekspert i fushës. Ushtrimi i të drejtës së parablerjes do të mundësohet në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të njoftuar rregullisht.
 - I njëjti rregull vlen edhe për dhurimin. Në çdo rast shumica e cilësuar do të japë miratimin për dhurimin e aksioneve.
 - Në këtë rregull bën përjashtim trashëgimia ligjore e vërtetuar sipas legjisacionit në fuqi.
 - Në çdo rast ortaku i ri që do të vijë në të ardhmen ka detyrim të pranojë këtë statut, deri sa ai të ndryshohet, sipas kushteve të parashikuara në këtë statut.

Neni 10 **Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve, me shumicë të cilesuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur vlerën e kuotave te ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Gjithashtu shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e cilesuar.
2. Nga Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të cilesuar të votave të ortakëve, do të miratohet edhe zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri.

Neni 11 **Blerja e Kuotave të Veta**

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre (jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpérndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja) vetëm nëse shoqëria përmbrush kushtet për shpérndarjen e fitimeve dhe Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen.

Kreu III **Asambleja e Përgjithshme**

Neni 12
Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Administratori/ët me të drejta të plota, thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe me kërkesën e ortakëve (që përfaqësojnë jo më pak se 5% të kuotave), do të proçedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe do t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë të plota përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
3. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje (nëse shoqëria ka mundësuar një të tillë).
4. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse shumica absolute është dakord, për të vazhduar mbledhjen, pavarësisht parregullsisë.

Neni 13
Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumi te parashikuar per çdo rast. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që i'u është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratori me te drejta te plota caktohet Kryetar i mbledhjes si edhe një person tjeter për të mbajtur procesverbalin e saj.
3. Nëse asnje prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnje prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm me të drejtë vote, me shumicë të thjeshtë, zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
4. Administratori, edhe nëse nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
5. Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kerkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Dite të Plota përparrë kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Ne rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

6. Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përparrë ose gjatë deklarimit të rezultatit, kur kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund te kërkohet nga:
 - i. Kryetari; ose
 - ii. Një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kérkesën e paraqitur nga vetë ortaku.
7. Deklarimi i Kryetarit dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes se :
 - i. vendimi është marre në mënyrë unanim, ose
 - ii. me një shumicë të caktuar, ose
 - iii. nuk është miratuar apo nuk është miratuar me një shumicë të caktuar përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
8. Në rast se ka kundërshtime nga ortaket për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit te votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 14 Votat e Ortakëve

1. Përvec rasteve kur në këtë statut kërkohet një shumicë e caktuar në vendim marrje, për çështje proceduriale të mbledhjes, çdo kuotë i jep të drejtën e një vote:
 - i. ortakut të pranishëm (në rastin kur është individ) apo përfaqësuesit të autorizuar prej tij ose
 - ii. ortakut (ne rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt.
2. Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do t'i komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Neni 15 Votimi me Prokurë

1. Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku (individ apo person juridik) sipas formës së mëposhtme (ose në formën që mund te miratohet nga Administratori/ët):
 “KK TERMOIDRAULIKA”

Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, ne cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më, ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më, dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Nënshkruar më.....”.

2. Në rastet kur ortaket do ta percaktojne vete votimin per çeshtjen/et konkrete, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mbledhjes (ose në formën që mund te miratohet nga Administratorët):

“KK TERMOIDRAULIKA”

Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, ne cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më, ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më, dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Vota është si më poshtë :

Vendimi Nr. 1, në lidhje me : *pro *kundër
Vendimi Nr. 2, në lidhje me : *pro *kundër.
(*do të fshihet zgjedhja e padëshiruar).

Përveç udhezimeve të mësipërme, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme.

Nënshkruar më.....”.

3. Emërimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët, depozitohet :
 - i. në selinë e shoqërisë ose
 - ii. në një vend tjeter brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ose
 - iii. në adresën e degës apo zyrës së përfaqësimit së shoqërisë ku do të kryhet mbledhja, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
4. Akti i emëritit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.
5. Në rast se akti i emëritit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*) sipas përcaktimeve të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 16
Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme me shumicë të cilësuar, merr vendim për:
 - i. vlerësimin e veprimitarisë së tij;
 - ii. shuarjen apo faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - iii. ngritjen e një padie ndaj tij prej shoqërise;
 - iv. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, edhe i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 17
Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate notieriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi. Ne cdo rast cilido ekspert i jashtem do te zgjidhet me shumice te cilesuar.

KREU IV
Administratori/ët

Neni 18
Emërimi i Administratorëve

1. Asambleja e përgjithshme, me shumicë të cilesuar, emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, me te drejta te plota. Afati i emëritimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
2. Asambleja e përgjithshme, me shumicë të thjeshtë, emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, me te drejta te kufizuara, te cilet do te mbikqyrin aktivitetin e perditshem te shoqerise, por pa te drejta mbi cdo forme te marredhenies financiare me bankat, me shtetin dhe cdo pale te trete tjeter. Afati i emëritimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Ne cdo rast, administratori me te drejta te kufizuara mund te emerohet vetem nese ka ne detyre te pakten një administrator me te drejta te plota.
3. Nëse shoqëria do të jetë shoqëri tregtare mëmë, administratorët nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
4. Administratorët e shoqërise, mund të emërohen si administratorë të një dege apo zyre përfaqësie të shoqërisë.
5. Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator me te drejta te plota te shoqërisë me afat 5 vjet nga momenti i emerimit te tij

Të dhënat e identifikimit:

- **Z. Kleviš Kapllaj**, i datëlindjes 30/04/1988, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhë dhe banues ne Lezhë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr 032360980 dhe Nr. Personal I80430053H

Neni 19 Kompetencat e Administratorit/ëve

Administratori/ët me të drejta të plota kanë të drejtë dhe detyrohen të:

1. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Bisnesit;
7. raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
9. Administratori/ët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
 - i. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - ii. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër, aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - iii. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
10. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
11. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me te njeften menyre që ai eshte zgjedhur, sipas shumices perkatese. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, irregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 20
Përfaqësimi

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve i kundërdrejtohen palëve të treta. Në çdo rast është përgjegjësi e administratorit që në takime apo marrëveshje me palë të treta të dorezojë ekstratin e Rregjistrat Tregtar me të dhënrat e Shoqërisë.
2. Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë një apo disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet qe i drejtohen secilit prej administratorëve janë të vlefshme dhe detyruese për shoqërinë.
3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
4. Administratorët mund t'uua delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosin Administratorët dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

Neni 21
Shkarkimi i Administratorëve

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. shkarkohet nga detyra ;
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese, në rastet e dëmshpérblimit dhe jo vetëm;
3. personi vuani ose mund të vuajë nga çrrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë jo më pak se 30 ditë përpara.

Neni 22
Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorëve

1. Administratorët me të drejta të plota shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme, me vendim të shumicës së cilësuar.
2. Administratorët me të drejta tëkuifizuara shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme, me vendim të shumicës së thjeshtë, por në asnjë rast nuk do të shpreblehen më shumë se 75% e pagës së Administratorit me të drejta të plota. Përashtim nga ky rregull bën vendim marrja e shumicës së cilësuar.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për :
 - i. çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, ne shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose ne shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese apo të filialeve të saj,

- ii. për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre.
- 4. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme.
- 5. Administratorëve mund t'iu paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Administratorëve ose të komiteteve të Administratorëve ose të Asamblesë së Përgjithshme si edhe ne levizjet drejt/per filialt e shoqerise, në lidhje me përmrbushjen e detyrave të tyre.

Neni 23 **Mbledhjet e Administratorëve**

1. Mbledhjet e Administratorëve do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme cakton njërin prej Administratorëve me te drejta te plota, me detyrën e Kryetarit të mbledhjes së Administratorëve, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo mbledhje të Administratorëve në të cilat ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga ora e caktuar për mbledhjen, Administratorët e pranishëm mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
3. Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
4. Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorëve, ose nga një komitet i Administratorëve, apo nga persona të cilët veprojnë si Administratorë, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e një Administratori ose njëri prej tyre ka qenë i skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëlloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si Administratorë dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.
5. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë Administratorët që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Administratorëve ose nga komiteti i Administratorëve do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëlloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Administratorëve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

Neni 24 **Kufizimet në Votimet e Administratorëve**

1. Administratorët nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Administratorëve për çështje në të cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:
 - i. të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe

- ii. të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.
- 2. Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 3. Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë.
- 4. Në rast se në mbledhjen e Administratorëve ose të komitetit të Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një Administratori, çështja mund ti drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpëra përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

Neni 25
Procesverbalet e Mbledhjeve të Administratorëve

Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

- 1. të gjitha takimeve të kryera nga Administratorët; dhe
- 2. të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjeve të Administratorëve dhe komitetet e Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

KREU V
Degët dhe zyrat e përfaqësimit

Neni 26
Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit

- 1. Shoqëria ka të drejtë të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda apo jashtë shtetit. Personat përgjegjëspëradministrimin me te drejta te plota teshoqërisë mund të vendosin hapjene tyre.
- 2. Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete si dhe ushtrojnë veprimitari me palë të treta, në emër të shoqërisë.
- 3. Zyrat e përfaqësimit janë vende të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Zyrat e përfaqësimit nuk kanë si qëllim krijimin e të ardhurave, por nxitjen e veprimtarisë së shoqërisë. Këto zyra mund të lidhin marrëveshje në emër e përllogari të saj.
- 4. Nëse degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërise krijojnë faqe interneti, ato duhet të publikojnë numrin unik të identifikimit të shoqërisë në këtë faqe interneti.
- 5. Dega vepron nën emrin e regjistruar të shoqërisë, si dhe nën emrin e saj.
- 6. Përfaqësuesi i degës apo zyrës së përfaqësimit, ëmërohet me shumicë te cilesuar të asamblesë së ortakëve, i cili sipas rastit mund të jetë administratori i shoqërisë dhe/ose një person tjetër.

3. me hapjen e procedurave të falimentimit;
4. me vendim të gjykates;
5. për arsyet tjetra, të parashikuara në statut
6. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Prishja e shoqërise ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Neni 31

Ndarja apo bashkimi me përthithje

1. Shoqëria mund të trasnformohet me ndarje apo mund të bashkohet me përthithje me shoqëri tjetra tregtare.
2. Për këtë rast do të vendosin ortakët që kanë shumicën e cilësuar të kapitalit të shoqërisë.


Neni 32

Njoftimet

1. Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin. Njoftimi elektronik do te merret i mirëqënë me çdo email me të cilin është përgjigjur të paktën një herë administratori i shoqërisë.
2. Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët.
3. Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).
4. Për ato që nuk parashikohen në këtë statut do të referohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

ORTAKET THEMELUES

Klevis KAPLLAJ



Faqe 14 nga 14

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
”KK TERMOIDRAULIKA” SHPK

Sot, më datë 13/09/2021, u paraqit personalisht:

- **Z. Kleviš Kapllaj**, i datëlindjes 30/04/1988, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhë dhe banues ne Lezhë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr 032360980 dhe Nr. Personal I80430053H

I cili përpiloj këte akt themelimi të shoqërisë tregtare “KK TERMOIDRAULIKA” SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Forma Ligjore

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "KK TERMOIDRAULIKA" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "KK TERMOIDRAULIKA" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "KK TERMOIDRAULIKA" SH.P.K dhe me emrin tregtar **KK TERMOIDRAULIKA**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Aktivitet ne fushen e ndertimit dhe rikonstruksionit te ndertimeve civile, objekte te sherbimit dhe banimit, punime hidraulike.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Lezhë, në adresën: **Lezhë, Shëngjin, Ishull Lezhë, Banesë private me Nr. Pas. 53/604, ZK Nr. 1986.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njeqind mijë leke) dhe zotërohet nga ortaket themelues:

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: Lekë 100.000 (njeqind mijë leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaket themelues.

NENI 7

Ortaket themeluese Shoqërisë Tregtare "KK TERMOIDRAULIKA" SH.P.K zotërojne kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues : **Kleviš Kapllaj**

Numri i kuotave : **1**

Numri i pjeseve : **1**

Pjesemarrja ne Shoqeri : **100,00 %**

Lloji i kontributit: **Ne para**

Vlera e kontributit **100,000 (Njeqindmije mijë) leke**

Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas rregjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.

Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne kete Statut.

NENI 8

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9

Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqerise do te jete :

- **Z. Kleviš Kapllaj**, i datëlindjes 30/04/1988, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhë dhe banues ne Lezhë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr 032360980 dhe Nr. Personal I80430053H

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënje me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjeter privat, me përashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues, u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaket janë njobës te gjuhes shqipe.

ORTAKET THEMELUES

Klevis KAPLLAJ

